

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 gusht 2010), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-150 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/03 prill 2017), si dhe nenin 103, paragrafi 1, dhe nenin 114 të Ligjit Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht 2024, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR AUDITIMIN E JASHTËM TË INSTITUCIONEVE MIKROFINANCIARE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

Qëllimi i kësaj rregullore është të plotësojë dhe ndryshojë Rregulloren për Auditimin e Jashtëm të Institucioneve Mikrofinanciare (IMF), të miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore me datë 29 gusht 2013 (më tutje: rregullorja bazë).

Neni 2

1. Paragrafi 5 i nenit 4 i rregullores bazë, ndryshohet me tekstin si në vijim:
 5. Punësimi i vazhdueshëm i auditorit të jashtëm të njëjtë është i kufizuar në pesë (5) vite të njëpasnjëshme, dhe auditori i jashtëm i njëjtë mund të marrë pjesë në auditimin e të njëjtës IMF përsëri, pas kalimit të periudhës kohore prej dy (2) vitesh nga angazhimi i tij i fundit në atë IMF.
2. Neni 4 i shtohet paragrafi 6 si në vijim:
 6. Në rastin kur auditori i jashtëm është aktualisht i angazhuar dhe miratuar nga BQK, me rastin e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, vazhdimi i angazhimit të tij mund të bëhet ashtu që në asnjë rast nuk kalon periudhën pesë (5) vjeçare nga data e angazhimit të parë.

Neni 3

Paragrafi 2 i nenit 8 të rregullores bazë, ndryshohet me tekstin si në vijim:

2. Auditorët e jashtëm të miratuar, gjithashtu, duhet të jenë në pajtim me dispozitat e Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim si dhe aktet e nxjerra nënligjore në zbatim të këtij ligji për çështjen e pavarësisë së auditorëve.

Neni 4
Efektet dhe hyrja në fuqi

1. Të gjitha dispozitat tjera të rregullores bazë, përveç dispozitave të ndryshuara dhe plotësuara me këtë rregullore, mbeten në fuqi.
2. Kjo rregullore lexohet dhe kuptohet si një me rregulloren bazë dhe konsiderohet pjesë përbërëse e saj, bashkë me dispozitat e ndryshuara të rregullores bazë.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi më 30 gusht 2024.

Bashkim Nurboja
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës